



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM
Nr .485, datë 14.10.2022

PËR MIRATIMIN E PËRQINDJES SË PAGESËS RREGULLATORE

Në mbështetje të nenit 10 të Ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura” i ndryshuar, të nenit 9 të “Metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve Ujësjetellës Kanalizime” dhe “Rregullores për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe të Largimit dhe Përpunimit të Ujërave të ndotura” duke qenë e nevojshme rritja e të ardhurave nga pagesa rregullatore për mbështetje financiare të ERRU-së, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Të aplikohet koeficienti 0.65 % mbi të ardhurat e parashikuara për llogaritjen e pagesës rregullatore për kontratat e reja në vijim.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike.
3. Vendimi i Komisionit Kombëtar Rregullator Nr.22, datë 14.11.2014 shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi më datë 01.01.2023.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Ndriçim Shani